



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .12.2024

MBLEDHJA Nr. 51,
Datë 13.12.2024, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 13.12.2024, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 51 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2025.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2024, si dhe ndryshimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C ENERGJI GOJAN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”.
4. Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria ALBGAZ sh.a.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI